286/20
28.05.20

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi – Hysni Muhadri	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
	18.0.2020	28.05.2020	286/20

Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën:14.05.2020, OE ankues **"SAMIR OSMANI B.I & DPT JONATAN-P"**– Suharekë, ka parashtruar ankesë me nr: 286/20, kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanusar për dhënie të kontratës OE NSHB "ZONA PARK" – Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "SPERKATJA NGA TOKA E ZONAVE ENDEMIKE NGA ETHET HEMORRAGJIKE", me nr. të prokurimit: 62500-20-927-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Malisheve **(KKM).**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 60.000,00 €.

Nuk është e përsëritur ankesa.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore të OE "SAMIR OSMANI B.I & DPT JONATAN-P" – Suharekë.

Neni 1 – Qëllimi;
Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 56 – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Neni 1 – paragrafi 1,2,3 – i Ligjit Nr. 04/L-042 Neni 1 Qëllimi 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të 3 autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. 2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. 3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellën duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësishtë procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji. Deklarata, Faktet dhe argumentet: Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur: AK – Komuna e Malishevës nuk ka trajtuar fondet publike me efikasitet, transparence sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi. Pasi ne si Grupi i Operatorëve Ekonomik "SAMIRE OSMANI" B.I. & D.P.T. JONATAN-P p.n. kemi ofertë më të lirë, dhe jemi oferte e përgjegjshme. AK – Komuna e Malishevës ka shkelur pasi zyrtarët publik të cilët janë pjesë e AK – Komuna e Malishevës, komisioni vlerësues dhe zyrtarë tjerë të cilët kanë qenë pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit nuk kanë punuar me integritet dhe përgjegjshmëri, dhe se nuk e kanë kryer punën në përputhje me rregullat dhe ligjet e LPP. Ne kërkojmë nga AK – Komuna e Malishevës të veproj konform rregullave dhe ligjeve në fuqi, dhe se në rast se ndodhë e kundërta ne do të ngrisim kallxim penal ndaj punonjëseve të cilët i tejkalojnë dhe shkelin rregullat dhe ligjet e LPP. AK – Komuna e Malishevës në trajtimin e ofertës sonë është treguar joprofesionale, është ndikuar , ka qene e anëshme ndaj një OE, nuk ka vepruar ndaj parimit te shfrytëzimit sa më efikas të fondeve dhe kosto ekonomike më të ulët, dhe se nuk është përmbajtur ndaj procedurave dhe rregullave të këtij ligji. Neni 6 – paragrafi 1 – i Ligjit Nr. 04/L-042 Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Deklarata, Faktet dhe argumentet: Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur: AK – Komuna e Malishevës ka shkelur pasi ne si Grupi i Operatorëve Ekonomik "SAMIRE OSMANI" B.I. & D.P.T. JONATAN-P kemi ofertuar me çmim prej 47,500.00 € (katër dhjete e shtatë mije e pese qindë €uro), ndërsa OE tjerë ne këtë aktivitet te prokurimit ka çmime te larta si 60,000.00 (gjashte dhjetë mijë €uro), është për 12,500.00 € (dymbëdhjetë mijë e pesëqindë euro më shumë se oferta jonë).

Neni 7 – paragrafi 1,2,4,6 – i Ligjit Nr. 04/L-042 Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. 4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose

imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik. 6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse. Deklarata, Faktet dhe argumentet: Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur: AK – Komuna e Malishevës ka shkelur ketë pike te LPP ne si Grupi i Operatorëve Ekonomik "SAMIRE OSMANI" B.I. & D.P.T. JONATAN-P jemi diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar të barabartë siç parashihet me rregullat dhe ligjet e prokurimit publike. Grupi i Operatorëve Ekonomik "SAMIRE OSMANI" B.I. & D.P.T. JONATAN-P produktet te cilat janë sipas kërkesës dhe te cilat janë ne harmoni me te gjitha normat dhe standardet ndërkombëtare dhe botërore te veprimtarisë sonë. Përderisa AK-Komuna e Malishevës këto produkte ka pretenduar qe nuk janë sipas standardeve, cilësisë dhe normave qe janë kërkuar ne aneksin 1 te specifikacionit teknik. Ne si OE jemi te përgjegjshëm dhe i plotësojmë te gjitha kërkesat ne njoftimin për kontrate, dosjen e tenderit dhe jemi te përgjegjshëm sipas rregullave dhe ligjeve te LPP ne fuqi përkundër kësaj ne si OE jemi diskriminuar dhe AK – Komuna e Malishevës me dt. 22.04.2020 nxjerr vendim për aktivitetit te prokurimit ku shpërblen me kontrate një OE i cili është me i shtrenjtë se ne. Ne si Grupi i Operatorëve Ekonomik "SAMIRE OSMANI" B.I. & D.P.T. JONATAN-P kemi kërkuar qasje ne informacione te projektit tek zyra e prokurimit, kemi kontaktuar përmes telefonit me zyrtaret përgjigjesh, te cilët kane hezituar te na lejohet asja ne dokumentacionet e fituesit te projektit te shpallur me vendimin e dt. 22.04.2020 nga AK - Komuna e Malishevës. Si dhe me vendimin e dt. 30.04.2020 ku Kërkesën tone për Rishqyrtim e hedhe poshtë. Vendimet e AK janë diskriminuese për ne si Grup i OE. Pasi AK – Komuna e Malishevës ka vepruar duke diskriminuar një OE ndërsa ka favorizuar një OE tjetër në këtë aktivitet te prokurimit. Neni 56 – paragrafi 1,3 – i Ligjit Nr. 04/L-042 Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave 1. Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes: 1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji; 1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji. 3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohen nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Deklarata, Faktet dhe argumentet: Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur: AK nuk janë respektuar kriteret për dhënien e kontratës, dhe se kontrata nuk ju është dhënë një OE i cili është përgjegjshëm dhe AK –Komuna e Malishevës ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë të këtij neni dhe se AK konkretisht komisioni vlerësues ka shkelur këto dispozita të këtij paragrafi. Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar dispozitat dhe ligjet ne fuqi mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe Dhënien e

Kontratës. AK – Komuna e Malishevës nuk ka respektuar kriteret në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, dhe se eliminimi jonë është një shkelje e kësaj dispozite, dhe se ne i plotësojmë të gjitha kushtet tek Njoftimi për Kontratë, Dosja e Tenderit dhe Specifikacionin Teknik. Neni 59 – paragrafi 4 – i Ligjit Nr. 04/L-042 Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve 2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Deklarata, Faktet dhe argumentet: Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur: AK – Komuna e Malishevës dhe komisioni vlerësuar nuk ka kryer vlerësim dhe krahasim te ofertave ne përputhje me LPP Grupi i Operatorëve Ekonomik "SAMIRE OSMANI" B.I. & D.P.T. JONATAN-P konstatojmë që jemi të përgjegjshëm dhe se i plotësojmë të gjitha kërkesat në NJK dhe DT, dhe se arsyet e eliminimit nga AK nuk janë arsye të cilat qëndrojnë , dhe se autoriteti kontraktues gjatë procesit te ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve është dashur që në pajtim me NJK dhe DT neve të na shpallë të përgjegjshëm dhe të na shpërblejë me kontratë. Ne konstatojmë që natarët e komisionit vlerësues kanë tejkaluar ushtrimin e punës dhe veprimtarie siç e përcakton ky neni 59, dhe dispozitat e ligjit të prokurimit publik. Njoftimi mbi Vendimin e AK – Letra standarde e eliminimit • Ju mungojnë Referencat ashtu siç janë kërkuar ne dosjen e tenderit referenca te shërbimeve te natyrës se njëjtë spërkatja nga toka e zonave endemike nga ethet hemorragjike Deklarata, Faktet dhe argumentet: Ne si Grupi i Operatorëve Ekonomik "SAMIRE OSMANI" B.I. & D.P.T. JONATAN-P kemi të dorëzuara listën e kontratave, referencave dhe të gjitha dokumentacionet tjera të cilat lidhen me këtë kërkesë ne NJK dhe DT, ne e plotësojmë këtë pikë. (Lista e kontratave, referenca, kontrata, fatura, dëshmi te pagesës etj) Shërbimet të cilat ne i kemi deklaruar në listën e shërbimeve dhe punëve të kryera e plotësojnë këtë kërkesë pasi që përdoren të njëjtat makineri, preparate për spërkatje. Ne jemi kompani e profesionalizuar në këtë veprimtari si D.D.D. (Dezinfektimi, Dezinsektimi, Deratizimi) dhe të gjitha shërbimet tona, referencat, kontrata janë për D.D.D. Dezinfektimi, Dezinsektimi, Deratizimi sikurse e njëjta që keni kërkuar ju në këtë aktivitet të prokurimit. • Ju mungojnë dëshmitë se keni të punësuar z.Kadri Cikaqi ne dëshmitë e juaja keni dorëzuar keni cekur se i njëjti do te filloj pasi te nënshkruhet kontrata për këtë projekte, ndërsa ne kemi kërkuar te dëshmoni se keni të punësuar dëshmi kemi kërkuar kontratën e punës. Deklarata, Faktet dhe argumentet: Ne si Grupi i Operatorëve Ekonomik "SAMIRE OSMANI" B.I. & D.P.T. JONATAN-P kemi të angazhuar me marrëveshje z. Kadri Cikaqin, i njëjti do të angazhohet për projektin në fjale siq citohet në dokumentacionet e kompanisë. Te bashkangjitura ne e-prokurim keni edhe diplomën e fakultetit, CV, ID dhe dëshmia qe i njëjti do te angazhohet për projekt. Me ligjet ne fuqi te LPP është e lejuar që një person profesional të angazhohet ne projekt, ju si AK-Komuna e Malishevës për projektin ne fjale nuk keni kërkuar përvojë për stafin profesional te angazhuar ne projekt. Ju si AK_Komuna e Malishevës dhe komisioni vlerësues nëse nuk keni pasur informacione të mjaftuara për z. Kadri Cikaqin, është dashur ti shfrytëzoni dispozitat ligjore Të LPP që për të njëjtin të kërkoni informacione shtesë nga ne, mirëpo ju nuk

keni kërkuar informacione shtesë, përkundër që të gjitha të dhënat i keni pasur të bashkangjitura ne e-prokurim. Andaj AK-Komuna e Malishevës dhe komisioni vlerësues ka kryer shkelje ne këtë pikë të vendimit të dt: 22.04.2020. si dhe dt. 30.04.2020.

• Produkti i ofruar nga ana juaj nuk është preparat sipas standardeve të BE-së ashtu siç është kërkuar nga ana jonë tek pjesa II – Përshkrimi i Çmimit të produktit ka origjinën nga vendi i BE (Bashkimi Evropian) Deklarata, Faktet dhe argumentet: Ne si Grupi i Operatorëve Ekonomik "SAMIRE OSMANI" B.I. & D.P.T. JONATAN-P kemi dorëzuar dhe ofruar produktet sipas kërkesës se AK-se dhe me standarde të cilat janë kërkuar, produktet e ofruara nga ne i përmbushin standardet e BE-së dhe të njëjtat janë të lejuara të importohen ne shtetin tone sipas vendimeve dhe licencave të cilat ju i keni ne e-prokurim. Eshte për keqardhje kur AK ne vendim te datës 22.04.2020 vendos argumente tjera ndërsa ne formularin e çmimit ka kërkuar diçka tjetër. Ky është teksti tek formulari i përshkrimit te çmimit : "Furnizimi dhe sperkatja me preparat nga familja Pyrethroid, Acarid ose ekuivalent, biocide të kombinuara me Ujë sipas udhëzimeve të prodhuesit të preparateve konform standardeve të BE-së dhe të lejuara për përdorim në Republikën e Kosovës." Ndërsa ne vendimin e dt. 22.04.2020 citohet nga AK: Produkti i ofruar nga ana juaj nuk është preparat sipas standardeve të BE-së ashtu siç është kërkuar nga ana jonë tek pjesa II – Përshkrimi i Çmimit të produktit ka origjinën nga vendi i BE (Bashkimi Evropian). AK-Komuna e Malishevës dhe komisioni vlerësues duhet ta kenë parasysh dhe të njoftohen me dallimet mes standardit dhe vendit te origjinës. Andaj ne si Grupi i Operatorëve Ekonomik "SAMIRE OSMANI" B.I. & D.P.T. JONATAN-P i plotësojmë në tërësi këtë pikë e cila është ne vendimin e dt. 22.04.2020 dhe jemi të përgjegjshëm. "Tek përshkrimi i çmimeve kërkohet që: Preparati të jetë nga familja Pyrethroid; Substancat aktive të preparatit, Alpha-cypermethrin dhe Tetramethrin i përkasin familjes së Piretroideve (http://www.fao.org/3/ë4601e08.htm) dhe (https://echa.europa.eu/substance-information/-/substanceinfo/100.028.829) të cilat janë të kombinueshme me ujë sipas udhëzimeve të prodhuesit (shiko në Material Safety Data Sheet dhe Etiketën e aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) Preparatet klasifikohen si Biocide në bazë të data bazës së Agjencisë Evropiane të Kemikateve (http://echa.europa.eu – agjenci e Bashkimit Evropian që merret me Regjistrimin, Evaluimin, Autorizimin dhe Ndalimin e Kemikateve). Ligji për Biocide në Kosovë LIGJI NR. 03/L-119, kërkon specifikisht që substanca apo substancat active të një preparati të jenë të lejuara për përdorim si Biocide nga ECHA. Në rast se plotësohen kriteret, atëherë preparatet rrjedhimisht regjistrohen dhe lejohen për përdorim në Kosovë. Kompania posedon leje për import të produkteve Biocideve në Republikën e Kosovës nga MMPH (kopja e lejes është dorëzuar në aplikim). Po ashtu, kompania ka furnizuar me vite me rrudhë produkte të ndryshme kompanitë që kanë ekskluzivitet shërbimet e Dezinfektimit, Deratizimit dhe Dezinsektimit me të njëjtat produkte nga prodhuesi i njëjtë. Për momentin kompania posedon leje për preparatet me materie active si (AlphaCypermethrin, Cypermethrin, Tetramethrin, Permethrin). Produkti ZINON-EW, i licencuar nga MMPH, është përdorur edhe më herët për luftimin e rriqërave në zonat endemike.

Sipas Autoritetit Kontraktues, në përshkrimin e çmimeve kërkohet që produkti të jetë konform standardeve të BE-së dhe nuk specifikohet origjina e produktit në fjalë.

Ky kriter është cekur në pikën 3 të shpjegimit nga AK mbi mos përmbushjen e kritereve të kërkuara.

Dokumenti i aprovimit të Alpha-Cypermethrinws si produkt biocid :

https://eurlex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32015R0405&qid=1587935490240&from=EN dhe https://eur-lex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/?qid=1587935490240&uri=CELEX:32015R0405

Dokument i aprovimit të Tetramethrin si produkt biocid : https://echa.europa.eu/substance-information/-/substanceinfo/100.028.829 https://eur lex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/?qid=1587935724321&uri=CELEX:32017R0698 Lista e substancave të

aprovuara në Bashkimin Europian: http://echa.europa.eu/web/guest/information-on-chemicals/biocidal-activesubstances Informata shtesë: https://echa.europa.eu/substance-information/ /substanceinfo/100.110.015 Dokumentet e sipërme dëshmojnë konformitetin e produktit dhe substancave sipas Rregulloreve, Legjislacionit dhe Standardeve të Bashkimit Evropian." NE KËRKOJM NGA OSHP – ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI QË ANKESËN TONË TA APROVOJ SI TË BAZUAR DHE PROJEKTIN TA KTHEJ NE RIVLERESIM DHE TA OBLIGOJ AK QE OFERTËN TONE TA TRAJTOJ SIPAS RREGULLAVE DHE LIGJEVE TË LPP. NË RAST SE AK NUK VEPRON NË PËRPUTHJE ME RREGULLAT DHE LIGJET NË FUQI NE SI OE DO TË PROCEDOJMË ME LËNDËN NË INSTITUCIONET KOMPETENTE QË PËRCAKTOHEN ME LIGJE DHE SE DO TË NGRISIM KALLZIM PENAL NDAJ PERSONAVE QË NE PRETENDOJMË QË KANË VEPRUAR NE KUNDËRSHTIM ME LIGJET NË FUQI.

Kriteret për vlerësim

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: 1.Përshtatshmëriae OE me kërkesat e nenit 65 të Ligjit Nr.04 L-042 – për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 deklarata nën betim. 2.Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. 3.Një vërtetim nga autoriteti kompetent gjyqësor i vendit te themelusit të tenderuesit (GjTHK) se tenderuesi nuk ka pengesa lidhur me Kërkesat e pershtatshmerise Pika 6.2 .nën a,c,d,e,f dhe pika 6.3 nen a.b. dhe d. të dosjes se tenderit (deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit).	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *a. Një deklaratë nën betim se ju i përmbushni kërkesat për përshtatshmëri të Ligjit Nr.04 L-042, për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e Aneksi 2 në dosjen e tenderit.* *b.Vertetimi nga Administrata Tatimore - duhet te dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për kontrate.* *c.Vërtetimin nga Gjykata - duhet te dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për kontrate. Në rast të dështimit të dorëzimit të dokumenteve nën pikën b. dhe c. tenderi në fjalë do të refuzohet.*
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: 1.Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve. 2.Regjistrimi i numrit fiskal ne ATK. 3.Çertifikata e TVSH-së. 4.Leja-licenca nga ministrit perkatese per kryerjen e sherbimeve të sperkatjes. 5.Leja per importim dhe perdorim të produkteve biocide.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *a.Vërtetimi nga Ministria për regjistrimçertifikata e biznesit me llojin e veprimtarive të regjistruara (kopje).* *2.Regjistrimi i numrit fiskal ne ATK.* *3.Çertifikata e TVSH-së.* *4.Leja-licenca nga ministrit perkatese per kryerjen e sherbimeve të sperkatjes.* *5.Leja per importim dhe perdorim të produkteve biocide.*
III.2.4) Kapaciteti ekonomike dhe financiare: 1.Qarkullimi financiar në tri vitet e shkuara nga data e njoftimit për kontratë minimum 90,000.00€	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *1.Raportin apo raportet përkatëse nga një ose më shumë banka per tri vitet e shkuara nga data e*

(nëntëdhjetëmijë euro).	*publikimit të njoftimit për kontratë që e pasqyrojn kete qarkullim.*
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1. OE të ketë se paku një (1) fumigator që montohet në kamionet. 2. Operatori Ekonomik duhet të paraqes listen e shërbimeve të njëjta të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. 3. OE të ketë ekspertin për lëminë e spërkatjes së siperfaqeve kunder rriqrave–një agronom, epidemiolog ose biolog i diplomuar në cilësi te ekspertit.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *Të sillet dëshmia mbi pronësin apo marrjen me qera të kësaj paisje për sperkatje.* *Të dorëzoni listen e shërbimeve të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit per kontrate e vertetuar nga ju, ku përfshihen tituj e projekteve, numri, datat e kontraktimit dhe përfundimit të tyre si dhe dëshmitë e përfundimit çertifikatat (raportet e pranimit), referencat për shërbimet etj. Nëse kontrata është e lidhur me përsona fizik, dëshmia e pagesës përmes bankës).* *Për ekspertin të sillet diploma ose çertifikata kopje, CV-ja e tij dhe kontrata e punës.*

Raporti i komisionit vlerësues

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni pasi ka analizuar ofertat, duke marr parasysh të gjitha kërkesat e FDT-së, për këtë lende, rekomandon ZP që fitues të shpallet OE NSHB "ZONA PARK" – Prizren, që ka ofertuar me çmim në vlerë: 60,000.00€.

Ky rekomandim i komisionit vlerësues është aprovuar dhe është bërë Njoftimi mbi vendimin e AK-së me 22.04.2020.

Operatori ekonomik ankues **"SAMIR OSMANI B.I & DPT JONATAN-P"**– Suharekë, ka ofertuar në vlerë totale të ofertës:47,500.00€.

Informacionet shtesë të marra me an të sqarimeve të kërkuara nga eksperti shqyrtues.

N/A

Vlerësimi sipas nenit 4.1.26 të LPP-së

N/A

Vendimet e mëparshme të PSH-së, lidhur me rastet e ngjashme

N/A

Arsyetimi për devijim nga praktika e mëparshme

N/A

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "SAMIR OSMANI B.I & DPT JONATAN-P" – Suharekë.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: *"Operatori Ekonomik duhet të paraqes listën e shërbimeve të njëjta të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë"*, **të dëshmitë dokumentare është kërkuar:** *"Të dorëzoni listën e shërbimeve të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontrate e vërtetuar nga ju, ku përfshihen tituj e projekteve, numri, datat e kontraktimit dhe përfundimit të tyre si dhe dëshmitë e përfundimit certifikatat (raportet e pranimit), referencat për shërbimet etj. Nëse kontrata është e lidhur me persona fizik, dëshmia e pagesës përmes bankës)".*

Opertatori ekonomik ankues në dosjen e tenderit ka ofruar kontrata dhe referenca (DDD) siç shihen edhe në listën më poshtë, mirëpo mendoj kontratat dhe referencat e prezantuar nuk janë të njejta me titullin e aktivitetit të prokurimit: "SPERKATJA NGA TOKA E ZONAVE ENDEMIKE NGA ETHET HEMORRAGJIKE".

" Samire Osmani " B.I.

LISTA E PROJEKTEVE TE REALIZUARA NGA
" Samire Osmani " B.I. NGA VITI 2018

No.	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]

SAMIRE OSMANI B.I.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: *"OE të ketë ekspertin për lëminë e spërkatjes së sipërfaqeve kundër rriqrave–një agronom, epidemiolog ose biolog i diplomuar në cilësi te ekspertit"*, **të dëshmitë dokumentare është kërkuar:** *"Për ekspertin të sillet diploma ose certifikata kopje, CV-ja e tij dhe kontrata e punës".*

Operatori ekonomik në dosjen e tenderit e ka ofruar Listën e stafit: Ku në ketë listë tek numri rendor 7. e ka deklaruar z.Kadri Cikaqi, të punësuar si agronom për ketë projekt.

7.**Kadri Cikaqi** do te punesohet ne kompanine tone si Agronom ne procesin e Dezinsektimit te Rriqnave ne komunen e Malishevës. A. do te fillojë punën menjehere me fillimin e zbatimit te projektit.

SAMIRE OSMANI P.F.

NUI : 811

Numri I TVSH-se: [illegible]

Emri dhe Mbiemri

Nënshkrimi

SAMIRE OSMANI

Europass

Europass Curriculum Vitae

Informatat Personale

Emri i mbiemri	**Kadri Cikaqi**
Adresa	**Doberdelan ,Suhareke / R. Kosoves**
Telefoni	**+38349 464 990**
Fakset	
Shtetësia qytetare	**Shqiptare**
Datëlindja	**24.03.1997**
Gjinia	**Mashkull**

Emri i ofruesit / kualifikimin	
Data	Fakulteti i Bujqesise dhe Veterinarise
Emri i institucionit	**Universiteti i Prishtines**
Diploma	**Diplome**

"SAMIRE OSMANI" B.I

NUI:811044247 Nr.i TVSH 330354621 , Bashkim Kabashi Pn Lesham , Suhareke 230
Kosovë; Tel: 045/061-343; 044/272-842

Me date 06.04.2020 lidhem kete kontrate ne mes z.Kadri Cikaqi dhe Samire Osmani B.I

KONTRATE

Biznesi Individual Samire Osmani me NUI 811044247 Nr.i TVSH 330354621 me adresë: Lesham, Suhareke 23000, Kosovë lidhe kete kontrate me z.Kadri Cikaqi - Udhëheqës me Investimet e Prokurimit dhe Departamentin e Buxetit, dhe me titul Agronom per anagzhim per shërbimet e **SPERKATJA NGA TOKA E ZONAVE ENDEMIKE NGA ETHET HEMORRAGJIKE nga Autoriteti Kontraktues KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE Nr.Prokurimit 62500-20-927-2-2-1**

Kontrata eshte valide nga data e nenshkrimit .Per anagzhimin z.Arsim Gashi do te paguhet ne vlerë 170 euro duke i bere 40 ore pune ne javë, dhe do ti paguhen te gjitha kontributet dhe tatimet sipas ligjeve ne fuqi.

SAMIRE OSMANI

SAMIRE OSMANI

Kadri Cikaqi

REPUBLIKA E KOSOVËS
UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

REPUBLIC OF KOSOVO
UNIVERSITY OF PRISHTINA
"HASAN PRISHTINA"

Diplomë Diploma

KADRI SHAQIR CIKAQI

BACHELOR NE EKONOMIA E BUJQESISE

BACHELOR ON AGRICULTURE ECONOMICS

Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 6

National Qualifications Framework: 6

Nr. 1000

Siç shihet edhe më lartë OE ankues për z. Cikaqi, si dëshmi në dosje e tenderit i ka ofruar Listën e stafit, CV-në, Kontratë dhe Diplomën, në listën e stafit shënon se i njëjti do të filloj punën me njëherë me fillimin e projektit, CV NUK ka asnjë përshkrim të përvojës së punës. Në kontratën e lidhur me dt:04.06.2020, në mes të Samire Osmani me NUI 81104427, Nr. TVSH 330354621 dhe z. Kadri Cikaqi, shënon Kontrata është valide nga data e nënshkrimit, për angazhimin z. Arsim Gashi do të paguhet në vlerë 170 €, duke i bërë 140 orë pune në javë.

Kontrata eshte valide nga data e nenshkrimit .Per anogzhimin z.Arsim Gashi do te paguhet ne vlere 170 euro duke i bere 40 ore pune ne jave dhe do ti paguhen te gjitha kontributet dhe tatimet sipas listave ne fuqi

Si sqarime shtesë OE ankues "SAMIR OSMANI B.I & DPT JONATAN-P", ja ka ofruar AK-së edhe një përgjigje dhe CV-in në lidhje me z. Muhamet Qadraku, e që i njëjti është në listën e stafit, ku në dosje të tenderit ishin të bashkangjitura Diploma dhe Kontrata (mungonte CV-ja).

EKO

Samire Osmani B.I

Pergjigje në kërkesën nga AK-Malishevë

Autoriteti Kontraktues –Komuna e Malishves perms thirrjes nga numri I telefonit 049 365-705 ne ora 10:26 me ka kerkuar dokumentet si ne vijim :

1.CV e epideomologut z.Muhamet Qadraku e te cilen Cv autoriteti Kontraktues e ka pranuar ne dosje permes e prokurimit mirpo perseri po na dergoj .Sa per sqarim kane kerkuar Epideomolog ose Biolog dhe ne te gjitha I kemi te bashkeangjitur ne dosje por perseri po na ri-dergojme.

2.Poashtu AK ka kerkuar edhe deshmi si faktura ose dud doganor per Fumigator qe montohet ne kamionet e ne I kemi pasur nje fakture qe shkruan Thermal Foger – Fumigator dore nga biznesi D.P.T"ADIS-B" me facture te dates 11.11.2017 andaj po na dergoj perseri kete facture dhe nje Dud Doganore I dates 31.10.2018 me dokument perejellese nga kompania Turke SE-FA te dates 26.10.2018 pasi qe disa here kam importuar vete keto paisje si Operator Ekonomike .Sqarime ne facture ne gjuhen turke shkruan SM 6OPORTATIV ILAQLAMA MAKINASI.Poashtu po ja bashkeangjes edhe fotot e fumigatorit qe montohet ne kamionet me paisje perejellese .

Operatori Ekonomike :

Samire Osmani B.I

S. Osmani SAMIRE OSMANI

europass	
Europass Curriculum Vitae	
Informatat Personale	
Emri e mbiemri	**Muhamet Azir Qadraku**
Adresa	**Radost =Rahovec/ R. Kosoves**
Telefoni	+383 (044) 354-953
Faksi	-
Kombësia nacionale	**Shqiptare**
Datëlindja	**23.10.1951**
Gjinia	**Mashkull**
Titulli i fituar i kualifikimit	Epidemiolog
Dega	Mjekesi
Emri i institucionit	**Universiteti i Kosoves në Prishtine**
Diplomës	**Diplome**
Vendi i punës për të cilin punoje	**Spitali regjional -Prizren**
Pozita	**Epideomolog**
Data	**01.07.1987**
Vendi i punës	**Prizren**

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron arsyeja e eliminimit të AK-së, ku AK-ja e eliminon OE ankues **"SAMIR OSMANI B.I & DPT JONATAN-P"**, me arsyetimin: *"Produkti juaj nuk është preparat sipas kërkesave të BE, ashtu siç është kërkuar nga ana jonë tek Pjesa II, është kërkuar që produkti të ka origjinë nga vendet e BE-së"*, sepse në dosjen e tenderit në rubrikën e tetë (8) është kërkuar vendi i origjinës, nuk është cekuar se a duhet të jetë nga BE apo ndonjë vend tjetër.

PJESA<Nr>								
NR.I ART.	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI PA TVSH-Ë	TVSH (%)	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH-Ë	ÇMIMI TOTAL ME TVSH-Ë	VENDI I ORIGJINËS
1								
2								
ETJ.								

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Kuvendi Komunal Malisheve (KKM).**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **"SAMIR OSMANI B.I & DPT JONATAN-P"**